


<p style="text-align: center;">DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHITJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</p>	<p style="text-align: center;">SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</p>	<p style="text-align: center;">POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</p>
--	--	--

SCA -08-0085

13 janar 2011

Paditës/Ankues



Të Përfaqësuar nga avokati [REDACTED], me adresë:
[REDACTED], Prishtinë.

Vs.

Të paditur

1. **Kuvendi Komunal**, Podujevë
2. **NSH [REDACTED]**, Podujevë
3. **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit**, e përfaqësuar nga Zyra e Çështjeve Ligjore e UNMIK-ut, Selia e UNMIK-ut, TSS , Prishtinë
4. **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rruga Ilir Komushevc, nr 8, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme), Trupi Gjyqësor i përbërë prej Norbert Koster, Gjyqtar Kryesues, Roxana Comsa dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtarë pas seancës vendim-marrëse të mbajtur me 13 janar 2011 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme. Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Podujevë, 214/2006 i datës 18 qershor 2008 vërtetohet.
2. Ankuesit obligohen që ti paguajnë bashkërisht shpenzimet gjyqësore në shumë prej 80 Euro për procedurën e ankimit në Dhomën e Posaçme.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 30 Mars 2006, paditësit kanë ushtruar padi pronësie pranë Dhomës së Posaçme për patundshmërinë e cila regjistrohet në fletën poseduese 1231, ngastra kadastrale 339/0 (kopsht) dhe 339/0 (ndërtesë), në vendin "Qyteza, me sipërfaqe prej 00.40 ha, në Komunën e Podujevës, kundër të paditurit të parë dhe të dytë. Paditësit gjithashtu kanë deponuar edhe një kërkesë për masë të përkohshme, në mënyrë që e paditura e parë por edhe e paditura e dytë të parandalohen nga marrja e çfarëdo veprimi lidhur me transferimin e patundshmërisë apo nga miratimi i çfarëdo pune ndërtimore mbi te. Paditësit kanë kërkuar që tu paguhen shpenzimet procedurale. Paditësit kanë thënë se patundshmëria u ishte marrë në mënyrë joligjore nga paraardhësit e tyre pa u kompensuar, dhe se toka e tyre nuk është shpronësuar apo konfiskuar. Paditësit kanë pohuar se edhe më herët në vitin 1993 ata kishin paraqitur kërkesa për pronën e tyre pranë Komisionit për Kthimin e tokave, në Komunën e Podujevës, dhe në vitin 2002 pranë Drejtoratit për Çështje Ligjore dhe të Pronave në Komunën e Podujevës të cilat iu kishin refuzuar. Pastaj paditësit kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale të Podujevës, e cila me 29 mars 2004 është deklaruar se padia bie nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme.

Me 18 maj 2006, Dhoma e Posaçme, SCC-06-0139, e ka referuar lëndën në Gjykatën Komunale të Podujevës me të drejtë ankimi pranë Dhomës së Posaçme.

Me 18 qershor 2008, Gjykata Komunale e Podujevës, C. nr. 214/2006, e ka refuzuar padinë si të pabazuar. Paditësit e kanë pranuar aktgjykimin me 15 korrik 2008 dhe kanë paraqitur ankim pranë Gjykatës Komunale të Podujevës brenda afatit (15 shtator 2008).

Ankesa së bashku me dosjen e lëndës i është përcjell Dhomës së Posaçme me 8 tetor 2008. Paditësit (këtu e tutje "Ankuesit") përveç kësaj kanë dorëzuar përkthimin në Anglisht të ankimit dhe aktgjykimin e gjykatës komunale. Ankimi bazohet në interpretim të gabuar të fakteve, në cenim bazik të së drejtës materiale dhe asaj procedurale. Ankuesit pohonin se gjykata komunale ka dështuar në trajtimin e padisë kundër Komunës së Podujevës; interpretimi i gjendjes faktike është i gabuar dhe se raporti i ekspertit i marrë në konsiderim nuk ka qenë profesional dhe se nuk e ka qartësuar gjendjen para vitit 1952. Në bazë të arsyeve të lartcekura, Ankuesit kërkojnë që aktgjykimi i gjykatës komunale të anulohet dhe që lënda të kthehet në rigjykim.

Me 7 prill 2009, ankimi së bashku me dokumentacionin përcjellës i është dërguar të paditurve, Komunës së Podujevës dhe NSH [REDAKTUAR] për Përgjigje.

Me 12 maj 2009, e paditura, NSH [REDAKTUAR] ka paraqitur përgjigje në ankim. E paditura propozon se ankimi duhet të refuzohet si i pabazuar sepse toka që në kontest evidentohet sipas fletës poseduese me numër 1231, ngastra kadastrale 339/1, me sipërfaqe prej 00.40 ha, ka qenë e regjistruar në emër të Ndërmarrjes që nga themelimi i saj në vitin 1952 si Kooperativa Bujqësore [REDAKTUAR] i. E paditura më tej tregon se fleta poseduese nr. 123 e paraqitur nga Ankuesit nuk ka ndonjë referencë me pronën në kontest, nuk ka vulë zyrtare apo datë andaj edhe nuk duhet të merret parasysh si provë nga Dhoma e Posaçme.

Me 2 qershor 2009, Dhoma e Posaçme ka vendosur që ta ftoi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit në padi si të paditur.

Me 17 qershor 2009, Ankuesit kanë paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e të paditurës së dytë. Ata deklarorin se deri në vitin 1952 prona iu përkiste paraardhësve të tyre [REDACTED] dhe se nuk e dinë se pse prona ka qenë e regjistruar në emër të Kooperativës Bujqësore [REDACTED]. Ata konsiderojnë se transferimi i tillë ka qenë i paligjshëm, i bazuar në ligj diskriminues dhe pa u kompensuar. Ata propozuan që Dhoma të kërkoj informacione nga Arkivi i Kosovës dhe Zyra Kadastrale e Komunës së Podujevës.

Në përgjigjen ndaj ankimit të paraqitur me 23 qershor 2009, AKP ka sugjeruar që ankimi duhet të refuzohet si i pabazë kurse aktgjykimi i gjykatës komunale të vërtetohet. Prona është e regjistruar si Shoqërore që nga viti 1950 në emër të KB [REDACTED]. Ankuesit nuk kanë arritur të ofrojnë dëshmi për siç thuhet të drejtat pronësore të paraardhësit të tyre. Fleta e posedimit e dorëzuar nuk është vërtetuar nga organi kompetent andaj edhe nuk është provë e mjaftueshme për të drejtat e thëna pronësore.

Me 29 qershor 2009, e paditura e tretë ka paraqitur përgjigje ndaj ankimit. UNMIK-u në emër të AKM-së ka njoftuar se ajo e përfaqëson NSH [REDACTED] konform Neneve 29.2 dhe 29.3 të Rreg. së UNMIK-ut 2002/12. dhe ka kërkuar që NSH-së ti ndalohet që ta përfaqësoi vetveten në këtë procedurë dhe që të bëjë parashtrësia tjera. Më tej ajo ka cekur se nuk ka të dhëna se prona i ka takuar Komunës së Podujevës e as Ankuesit nuk e pohojnë këtë. Pjesëmarrja e Komunës nuk është relevante për gjykimin e padisë pronësore prandaj edhe ankimi në këtë pjesë duhet të refuzohet. Lidhur me siç thuhet vërtetim të gabuar të fakteve relevante, AKM thotë së gjykata komunale e ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të evidencës kadastrale të vitit 200 dhe mendimit të ekspertëve gjyqësor, kurse Ankuesit nuk kanë siguruar prova të besueshëm për të drejtat e pohuara të tyre pronësore. Sa i përket të thënieve për zbatim të gabuar të drejtave materiale, AKM pohon se Ankuesit nuk e kanë materializuar asnjë fakt të besueshëm. Fleta poseduese nr. 123 e datës 20 prill 1923 nuk është konsideruar si autentike nga Gjykata Komunale e Podujevës andaj nuk përbën asnjë provë për pohimet e tyre. Veç kësaj, Ankuesit nuk kanë siguruar asnjë provë për siç thonë të drejtat pronësore midis viteve 1923 dhe 1952. AKM, më tej, ka treguar se NSH- i ka fituar të drejtat e tyre me regjistrimin në regjistrat kadastral në pajtim me nenin 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore të Pronës nr. 6/80. Në bazë të asaj që u tha më lart, AKM propozon që ankimi të refuzohet si i pabazuar dhe që aktgjykimi i gjykatës komunale të vërtetohet.

Arsyet Ligjore:

Ankimi është i pranueshëm, por i pabazuar. Në bazë të Nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaçme ka vendosur që të hiqet pjesa gojore e procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar me të cilin refuzohet padia si e pabazuar vërtetohet. Dhoma e Posaçme e vërteton arsyetimin ligjor në kuptim të mos dëshmimit të siç pretendohet të drejtave pronësore dhe shpronësimit të paligjshëm të vitit 1952. Paditësit nuk kanë

prezantuar fakte dhe dëshmi mbi të cilën ata e bazojnë padinë e tyre në kuptim të Nenit 219 të Kodit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare nr. 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596 të RSFJ-së. Gjykata komunale me të drejtë ka marrë parasysh shënimet kadastrale për pronën dhe raportin e ekspertit të paraqitur në gjykatë me 18 qershor 2008. Ekspertët kanë cekur se shënimet kadastrale datojnë që nga viti 1952 kur prona regjistrohej si shoqërore në emër të paditues NSH dhe se nuk ka patur ndryshime të mëvonshme. Regjistrimi i pronës është evidentuar në listën poseduese nr. 80 me kopje të planit kadastral të datës 1952 dhe në fletën poseduese nr 1231 me kopje të planit kadastral të datës 19 mars 2008. Raporti i ekspertit është paraqitur nga ekspertët gjatë seancës gjyqësore të datës 18 qershor 2008 dhe ai nuk është kontestuar nga palët.

Ankuesit nuk kanë paraqitur kërkesë për prova të reja në kuptim të Nenit 64 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Argumentet se raporti i paraqitur në shkallën e parë nuk është i plotë sepse nuk ka siguruar informacion për mënyrën e shpronësimit dhe historianin e pronës para vitit 1952 nuk mund të merren për shkak të arsyeve të lart-cekura.

Lidhur me faktin se e paditura nr. 1- Komuna e Podujevës- nuk përmendet në aktgjykimin e shkallës së parë, këtë trup gjykues e kupton si çështje jo të rëndësishme. Vërtetë, padia kundër Komunës nuk është tërhequr dhe rrjedhimisht Komuna është dashur të radhitet si e paditur në aktgjykimin e shkallës së parë. Gabimi përkatës, sidoqoftë, është gabim teknik i cili mund të përmirësohet me një vendim të gjykatës së shkallës së parë me të cilin plotësohet aktgjykimi. Palët janë të lira që të kërkojnë një plotësim të tillë nëse ato e shohin të duhur.

Taksat Gjyqësore

Në bazë të Rregullave plotësuese Procedurale të DHPGJS-së, lidhur me taksat gjyqësore në fuqi që nga 10 Marsi 2010 (bazuar në Nenin 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6) zbatohen këto taksa gjyqësore:

Tarifa për Shpenzime Gjyqësore, Neni 10.11 (paraqitja e ankimit) -----30 Euro

Tarifa për Shpenzime Gjyqësore, Neni 10.21
lidhur me 10.12 dhe 10.1 (vendimi në shkallën e dytë)----- 50 Euro

Gjithsej-----80 Euro

Shpenzimet gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit, siç përcaktohet me Nenin 10.21, lidhur me Nenin 10.12 dhe 10.1 mbi Tarifat e Shpenzimeve Gjyqësore duhet të caktohen sipas vlerës së padisë. Nuk ka fjali as në shkallën e parë e as në të dytën mbi vlerën e padisë. Andaj, shpenzimet gjyqësore për aktgjykimin në shkallën e dytë caktohen në shumë prej 50 Euro.

Shpenzimet gjyqësore barten nga Ankuesit të cilët janë të obliguar që ta paguajnë (bashkërisht) shumën e lart-cekur në Dhomën e Posaçme (shih Nenin 2 (1) të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, Gazeta Zyrtare e KSA Kosovës e datës 3 tetor 1978).

Andaj është vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankimi me shkrim kundër këtij aktgjykimi mund të dorëzohet në Panelin e Ankimeve të DHPGJS-së, brenda 30 ditëve nga data e pranimin të këtij aktgjykimi.

Nobert Koster, Gjyqtar Kryesues
EULEX

Roxana Comsa, Gjyqtare
EULEX

Ilmi Bajrami, Gjyqtar

Tobias Lapke, Regjistruer
EULEX